ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SPITALI REGJIONAL - PRIZREN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220/70010-26-8849-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me reagjenta laboratorike imunologjike dhe biokimike për aparatin atellica IM1600, Respons 600c dhe BC-700&20, Atellca DCA, BFTII, Atellica LumiQ**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**" UNI - CARE " SH.P.K.**
NUI	**600217857**
Adresa	**Rruga Uran Ajeti , Prishtine**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**049658655**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Yll Bajrami**
Adresa elektronike	**yll.bajrami@unicare-ks.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**25.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Loto 1 Furnizim me reagjenta laboratorike imunologjike për aparatin atellica IM1600[]Loto 2 Furnizim me reagensa për aparatin biokimik për aparatin Respons 600c[]Loto 3 Furnizim me reagjenta për aparatat laboratorik BC-700&20, Atellca DCA, BFTII, Atellica LumiQ

Ankesa drejtohet kundër njoftimit për kontratë të datës 14.10.2026 dhe dosjes së tenderit për Lotet 1, 2 dhe 3, si dhe kundër Vendimit të AK-së të datës 24.11.2026 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Dosja kërkon reagjenta, kalibratorë dhe kontrolla vetëm me emër tregtar dhe kode të një prodhuesi të vetëm, për pajisjet e dhuruara nga donatori (Siemens Atellica IM 1600, DiaSys respons 600c, Mindray BC-700/20), pa klauzolën "ose ekuivalent". Spitali ka në përdorim pajisjet funksionale Abbott Architect i1000SR, Architect c8000 dhe CELL-DYN Emerald, të blera me fonde publike, të cilat kryejnë të njëjtat analiza. AK pranon në vendim se procedura "është hartuar ekskluzivisht për pajisje të tjera laboratorike". Kështu konkurrenca kufizohet vetëm te donatori, në kundërshtim me nenet 1, 6, 7, 27 dhe 28 (par. 2 dhe 7) të LPP-së. Vlera e parashikuar: 745.476,00 € për 36 muaj.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Më 28.10.2026 OE ka paraqitur kërkesë për informacione shtesë (Aneksi 5), duke

kërkuar që dosja të lejojë oferta edhe për reagjentët e pajisjeve funksionale Abbott Architect i1000SR, Architect c8000 dhe CELL-DYN Emerald, si dhe arsyetimin e vlerës së parashikuar dhe të sasive. AK u përgjigj më 13.11.2026 pa iu përgjigjur pyetjes kryesore. Më 18.11.2026 OE paraqiti kërkesë për rishqyrtim sipas nenit 108/A të LPP-së. Me Vendimin e datës 24.11.2026, AK e refuzoi kërkesën, vërtetoi njoftimin për kontratë dhe vendosi të vazhdojë aktivitetin e prokurimit. Në vendim AK pranon se procedura "është hartuar ekskluzivisht për pajisje të tjera laboratorike" dhe se pajisjet Abbott do të hiqen nga përdorimi nga fillimi i vitit 2027 dhe do të tjetërsohen. Në këshillën juridike AK e udhëzon OE-në t'i drejtohet OSHP-së sipas nenit 109 të LPP-së. Kopja e Vendimit të AK-së të datës 24.11.2026 bashkëngjitet kësaj ankese.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (LPP):
1. Neni 1 - Qëllimi: fondet publike duhet të përdoren në mënyrën më efikase, ekonomike, transparente dhe të drejtë. Një procedurë e përcaktuar paraprakisht për një prodhues të vetëm e mohon këtë qëllim.
2. Neni 6 - Ekonomizimi dhe efikasiteti: heqja nga përdorimi dhe tjetërsimi i pajisjeve funksionale Abbott të blera nga spitali, si dhe rritja e vlerës së kontratës në 745.476,00 € pa analizë të kostos për test, e shkelin detyrimin për përdorim ekonomik të fondeve publike.
3. Neni 7 - Barazia në trajtim / mosdiskriminimi: dosja lejon të ofertojnë vetëm operatorët që furnizojnë reagjentët e donatorit dhe i përjashton paraprakisht operatorët e tjerë.
4. Neni 27 - Dosja e tenderit: dosja krijon pengesa të paarsyeshme për konkurrencë.
5. Neni 28, paragrafi 2 - Specifikimet teknike: AK-së i ndalohet të hartojë specifikime që favorizojnë ose disfavorizojnë operatorë ekonomikë. AK pranon se specifikimet janë "përshtatur" me pajisjet e donatorit.
6. Neni 28, paragrafi 7: specifikimet nuk duhet t'i referohen markës, markës tregtare, tipit apo origjinës së caktuar. Çdo referencë e lejuar përjashtimisht duhet të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent". Dosja përmban vetëm emra tregtarë dhe kode të një prodhuesi, pa këtë klauzolë.
7. Neni 108/A - Zgjidhja paraprake e mosmarrëveshjeve: AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim pa e shqyrtuar në mënyrë meritore dhe pa iu përgjigjur pretendimeve ligjore të OE-së.
Dispozita të tjera: Neni 414 i Kodit Penal Nr. 06/L-074 (Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar) - përmendet në lidhje me kërkesën që OSHP t'i njoftojë organet kompetente për rrethanat e donacionit, pa paragjykuar vlerësimin e tyre.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. TË DY SISTEMET E PAJISJEVE KRYEJNË TË NJËJTËN PUNË. Laboratori i AK-së ka dy sisteme funksionale për të njëjtat fusha: Imunologji - Abbott Architect i1000SR (i blerë nga AK) dhe Siemens Atellica IM 1600 (donacion); Biokimi - Abbott Architect c8000 (i blerë nga AK) dhe DiaSys respons 600c (donacion); Hematologji - Abbott CELL-DYN Emerald (i blerë nga AK) dhe Mindray BC-700/20 (donacion). Të dy sistemet kryejnë të njëjtat analiza, me të njëjtin qëllim klinik dhe të njëjtat parametra. Këtë e dëshmon vetë AK: në sqarimin e datës 13.11.2026 (pika 3) AK ka krahasuar çmimet e dy sistemeve artikull për artikull, për të njëjtat analiza (Troponin I, TSH, FT3, FT4, CA 15-3, CA 125, Vitamina D, Ferritin, D-Dimer, CK-MB, Kreatininë, Urea, HbA1c, Glukozë, AST, CRP, Bilirubinë, ALT). Nëse AK mund t'i krahasojë dy sistemet test për test, ato janë funksionalisht ekuivalente dhe mund të konkurrojnë në të njëjtën procedurë. Nuk ka asnjë arsye teknike që reagjentët për pajisjet Abbott të përjashtohen.
2. AK PRANON SE DOSJA ËSHTË HARTUAR EKSKLUZIVISHT PËR DONATORIN. Në Vendimin e datës 24.11.2026, AK deklaron se nuk pranohen oferta për reagjentët e pajisjeve Abbott "për arsye se kjo procedurë prokurimi është hartuar ekskluzivisht për pajisje të tjera laboratorike" dhe se specifikimet "janë përshtatur me sistemet e reja". Kjo është pranim i drejtpërdrejtë i shkeljes së nenit 28 të LPP-së. Të gjithë artikujt në Përshkrimin e Çmimeve janë me emër tregtar dhe kode të një prodhuesi të vetëm, pa klauzolën "ose ekuivalent". Kështu spitali e kufizon konkurrencën vetëm te donatori. AK nuk ka dhënë asnjë arsyetim pse objekti nuk mund të përshkruhej në mënyrë funksionale, sipas analizave dhe çmimit për test.
3. DONACIONI I LIDHUR ME BLERJE EKSKLUZIVE 36-MUJORE. Pajisjet e dhuruara (226.472,90 € sipas AK-së) janë kusht për blerjen ekskluzive të reagjentëve për 36 muaj në vlerë 745.476,00 €. Pajisjet hyjnë pa procedurë konkurruese, kostoja e tyre dhe e servisimit përfshihet në çmimin e reagjentëve, dhe tregu mbyllet për çdo operator tjetër. AK deklaron gjithashtu se pajisjet Abbott "nuk do të jenë më në përdorim duke filluar nga fillimi i vitit 2027" dhe "do të tjetërsohen". Pra, AK ka vendosur të heqë nga përdorimi pajisje funksionale, të blera me fonde publike, para përfundimit të procedurës. Kjo tregon se rezultati është përcaktuar paraprakisht dhe bie ndesh me nenin 6 të LPP-së.
4. VLERA E PARASHIKUAR DHE SASITË NUK JANË ARSYETUAR. AK nuk ka dorëzuar analizë të çmimit për test as analizë të konsumit real. Në sqarimin e 13.11.2026 vetë AK pranon se vlerat e krahasuara "nuk janë domosdoshmërisht çmime për një numër identik testesh", se duhet bërë "normalizimi i kostos për test real" dhe se "jo çdo artikull i donatorit është më i lirë". Vlerat që AK i quan "OE Paraprak" (94.258,50 Euro dhe 141.350,19 Euro) janë vlerat tavan të kontratave kornizë 2025-2026, jo çmime për të njëjtat teste. Sipas llogarisë së AK-së, kostoja e donatorit do të ishte rreth 420.853 Euro për 36 muaj, ndërsa vlera e tenderit është 745.476,00 Euro , më e lartë se shpenzimi real historik me reagjentët e OE-së (rreth 670.388 Euro për tri vite). Kursimi i pretenduar nuk është vërtetuar. Dhe kjo shtyn te mendojm se Ak don edhe mi pagu
5. PRETENDIMET PËR SERVISIM TË DOBËT JANË TË PAVËRTETA. Intervenimet e servisit janë kryer gjithmonë në kohë. OE posedon raporte pranimi dhe raporte servisi të

nënshkruara nga stafi i AK-së, të cilat dëshmojnë se pajisjet kanë qenë në gjendje të rregullt pune. Gjatë kontratave nuk ka pasur asnjë ankesë nga stafi i laboratorit apo nga spitali. AK nuk ka paraqitur asnjë dëshmi për pretendimet e saj.
6. VENDIMI I AK-SË NUK ËSHTË ARSYETUAR. AK i cilëson pretendimet e OE-së si "jo të bazuara me asnjë argument ligjor", edhe pse kërkesa mbështetej në nenet 1, 6, 7 dhe 28 të LPP-së, dhe nuk e analizon asnjërën.
.

7. VLERA E KONTRATËS TREGON SE AK SYNON TA PAGUAJË DONACIONIN, JO TË KURSEJË FONDE PUBLIKE. Sipas sqarimit të AK-së të 13.11.2026 (pika 3.3), reagjentët e donatorit kushtojnë rreth 140.284,43 EUR në vit, pra 40,46% më pak. Nëse kjo do të ishte e vërtetë, nevoja për 36 muaj do të ishte rreth 420.853 EUR. Megjithatë vlera e tenderit është 745.476,00 EUR: 324.623 EUR më shumë se llogaria e vetë AK-së, më shumë se shpenzimi real historik (rreth 670.388 EUR për tri vite), dhe diferenca e kalon edhe vlerën e deklaruar të pajisjeve të dhuruara (226.472,90 EUR). Ky fakt na bën të mendojmë se AK synon ta paguajë donacionin përmes çmimit të reagjentëve, dhe jo të kursejë mjete nga buxheti i shtetit. Kjo bie ndesh me deklaratën e AK-së se pajisjet janë ofruar "pa kosto të drejtpërdrejtë" (sqarimi, pika 2). Nëse kjo praktikë pranohet, çdo kompani mund të "dhuronte" pajisje dhe pastaj ta rikthente vlerën e tyre përmes reagjentëve të shitur me çmim më të shtrenjtë, në një tender të mbyllur për konkurrencën. Në atë rast pajisjet nuk janë donacion, por blerje e fshehur jashtë procedurës konkurruese, në kundërshtim me nenet 1, 6 dhe 7 të LPP-së.
8. DONACION SOT, TENDER I MADH PËR TË NJËJTAT PAJISJE PAS PAK JAVËSH. Sipas dokumentit të vetë AK-së, donacioni bazohet në listën e pajisjeve të datave 17.07.2026 dhe 08.09.2026. Njoftimi për kontratë u publikua më 14.10.2026, rreth pesë javë pas dokumentit të fundit të donacionit, për reagjenta që përdoren vetëm në pajisjet e dhuruara, për 36 muaj dhe me vlerë 745.476,00 EUR. Një donacion jepet pa kushte dhe pa pritje kundërshpërblimi. Kur pranimi i pajisjeve "falas" pasohet menjëherë nga një tender i "hartuar ekskluzivisht" për pajisjet e donatorit, ky nuk është donacion, por transaksion i kushtëzuar, ku pajisjet paguhen më vonë përmes kontratës së reagjentëve. Në vlerësimin tonë, një veprim i tillë, me të cilin përmes pozitës zyrtare favorizohet një operator i caktuar dhe dëmtohet buxheti publik, mund të përmbajë elementet e veprës penale "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar" sipas nenit 414 të Kodit Penal Nr. 06/L-074. Vlerësimi i përgjegjësisë penale është në kompetencë të organeve të ndjekjes.
9. KONTRADIKTAT NË PËRGJIGJET E AK-SË:
(a) AK thotë se donacioni sjell "zvogëlimin e varësisë nga një sistem i vetëm aparaturash" (sqarimi, pika 2), por dosja e lidh spitalin ekskluzivisht me një prodhues për 36 muaj dhe pajisjet Abbott hiqen nga përdorimi në 2027. Varësia rritet (nenet 7 dhe 28).
(b) AK thotë "pa kosto të drejtpërdrejtë" (pika 2), por kostoja e pajisjeve futet në vlerën e tenderit (nenet 1 dhe 6).
(c) AK thotë se reagjentët e donatorit janë 40,46% më të lirë (pika 3.3), por vlera e kontratës rritet 11,2% mbi shpenzimin historik (neni 6).
(d) Në Vendim AK thotë se analiza krahasuese "është dhënë në sqarimin e datës 28.10.2026". Më 28.10.2026 nuk ka sqarim të AK-së: atë ditë OE paraqiti kërkesën. Sqarimi i 13.11.2026 vetë pranon se "normalizimi i kostos për test real" ende duhet bërë (neni 108/A).
(e) AK thotë se analiza e konsumit real "është dhënë", por sqarimi nuk përmban asnjë

analizë të konsumit, vetëm përqindjet e realizimit që i dha OE (nenet 6 dhe 108/A).
(f) AK thotë se sistemet e reja kanë "teknologji dhe karakteristika të ndryshme operuese", por vetë i krahason të dy sistemet test për test (neni 28 par. 2 dhe 7).
(g) AK llogarit kursim prej 32.000 EUR nga servisi (pikat 4.1-4.2), por vetë shkruan se "duhet të konfirmohet se kjo mbulon të gjitha intervenimet" (neni 6).
(h) AK pretendon "prishje të shpeshta" dhe ankesa të stafit (pikat 1 dhe 8) pa asnjë dëshmi, dhe pretendimi nuk përsëritet në Vendim (neni 7).
(i) AK pretendon mungesë reagjentësh (pikat 4-5), por kontratat kornizë nuk janë shteruar asnjëherë (realizimi 52-95%).
(j) AK thotë se pretendimet e OE janë "pa asnjë argument ligjor", por kërkesa citon nenet 1, 6, 7 dhe 28 të LPP-së, të cilat AK nuk i analizon (neni 108/A).

10. HEQJA NGA PËRDORIMI DHE TJETËRSIMI I PAJISJEVE FUNKSIONALE TË BLERA ME FONDE PUBLIKE. Në Vendimin e datës 24.11.2026, AK deklaron se pajisjet laboratorike Abbott Architect i1000SR, Architect c8000 dhe CELL-DYN Emerald "nuk do të jenë më në përdorim duke filluar nga fillimi i vitit 2027, dhe të njëjtat do të tjetërsohen". Megjithatë, vetë AK nuk pretendon se këto pajisje janë të prishura apo jashtë funksionit. Përkundrazi, pajisjet janë të blera nga vetë spitali me fonde publike, janë në gjendje pune dhe me to janë kryer analizat laboratorike deri më sot. Nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore që e lejon një institucion publik të heqë nga përdorimi, pa arsye të bazuar, pasuri funksionale të blerë me para publike. Sipas Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, tjetërsimi i pasurisë jofinanciare bëhet përmes komisionit të emëruar dhe i përket pasurisë së papërdorshme ose jashtë funksionit, jo pajisjeve që punojnë. Heqja e pajisjeve funksionale, me qëllim që spitali të detyrohet të blejë për 36 muaj reagjenta në vlerë 745.476,00 EUR vetëm për pajisjet e donatorit, bie ndesh me parimin e përdorimit ekonomik dhe efikas të fondeve publike sipas nenit 6 të LPP-së dhe sipas Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Fakti që vendimi për tjetërsim është marrë para përfundimit të këtij aktiviteti të prokurimit tregon se rezultati i procedurës është përcaktuar paraprakisht në favor të donatorit, e jo për arsye teknike. Prandaj OE i propozon OSHP-së që t'i kërkojë AK-së: (a) vendimin dhe raportin e komisionit për vlerësimin e gjendjes së pajisjeve Abbott Architect i1000SR, Architect c8000 dhe CELL-DYN Emerald; (b) arsyetimin me shkrim pse pajisje funksionale hiqen nga përdorimi dhe tjetërsohen; (c) vlerën kontabël të këtyre pajisjeve në regjistrin e pasurisë së institucionit. Nëse një raport i tillë i komisionit nuk ekziston, kjo e dëshmon edhe më tej se vendimi nuk bazohet në gjendjen teknike të pajisjeve, por në synimin për ta favorizuar donatorin.

KËRKESAT: OE i propozon OSHP-së: (1) të pezullojë aktivitetin e prokurimit deri në vendimin përfundimtar; (2) të caktojë ekspert shqyrtues për ekuivalencën funksionale të dy sistemeve; (3) ta aprovojë ankesën si të bazuar; (4) ta anulojë Vendimin e AK-së të 24.11.2026 dhe njoftimin për kontratë të 14.10.2026, ose ta kthejë në rivlerësim me urdhër që AK të lejojë oferta edhe për reagjentët e pajisjeve Abbott ose të shtojë klauzolën "ose ekuivalent", t'i vlerësojë ofertat sipas çmimit për test dhe ta arsyetojë vlerën e parashikuar;
(5) t'ia kthejë OE-së tarifën e ankesës sipas nenit 118 të LPP-së
(6) OE i propozon OSHP-së t'i kërkojë AK-së dokumentacionin e plotë të donacionit (marrëveshjen, kushtet, vendimin për pranim dhe miratimet) dhe, brenda kompetencave të veta, t'i njoftojë organet kompetente (Prokuroria e Shtetit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit) për rrethanat e donacionit të lidhur me këtë tender.

Theksojmë se qëllimi i kësaj ankese nuk është përjashtimi i pajisjeve të dhuruara apo pengimi i furnizimit me reagjentë për këto pajisje. Kërkesa jonë është që të na mundësohet edhe neve ofertimi i reagjentëve për pajisjet ekzistuese Abbott, të cilat aktualisht janë funksionale dhe në përdorim.

Në këtë mënyrë, AK do të mundësonte konkurrencë të mirëfilltë ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke siguruar shfrytëzim sa më ekonomik dhe efikas të buxhetit publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkelja e pretenduar i shkakton OE-së dëm të drejtpërdrejtë, sepse specifikimet e dosjes e përjashtojnë paraprakisht nga mundësia për të ofertuar reagjenta për pajisjet funksionale Abbott, të cilat OE i ka furnizuar në laboratorin e AK-së prej 6 vitesh. Kështu OE humbet mundësinë për të konkurruar për një kontratë 36-mujore me vlerë të parashikuar prej 745.476,00 €. Në këtë fazë OE nuk paraqet kërkesë për kompensim; kërkon që procedura të korrigjohet dhe konkurrenca të lejohet.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*